

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE  
NR. 30559

VENDIM

MBI REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me daten 14.11. 2003, une  
gjqytarja M. Dedë prane Gjykates se , shkalles se  
Pare Tirane , pasi u njoha me krkesen e bere nga  
administratori "NDP" shpk,

KONSTATOVA

Sipas dokumentacionit, te paraqitur nga administratori,  
eshte formuar shoqeria "NDP" shpk me qender ne Tirane  
Rr. "Mihal Grameno" Nr. 82/1, Ap. 7, me kohezgjatje 20 vjet, me  
objekt veprimtarie :

Mirembajtje dhe riparim i pompave te karburantit dhe  
gazit te lengshem, mirembajtja e linjave elektrike ne  
stacionet e depot e karburanteve, mirembajtja dhe riparim i  
instalimeve dhe programeve kompjuterike , te depozitave te  
karburanteve dhe te gazit te lengshem . Sherbime te  
ndryeshme qe lidhen me rrjetin kompjuterik ndermjet  
satcioneve te shitjes se karburanteve e sherbimeve  
komplekse e depozitave te kaburantit ose te GPL .  
Mirembajtja dhe sherbimi i aparaturave te ndryshem si  
elektronike dhe mekanike te cilat perdoren ne stacionet e  
shitjes e depozitave te karburanteve , Furnizimin me pjeset  
e kembimit te nevojshme gjate periudhes se garancise per  
pompat karburantit , aparatura e sisteme kompjuterike etj,  
qe i sherbejne qellimit te mesipem . Shoqeria do te marre  
gjithashtu koncensione , eskuzivitete dhe perfaqesi per  
shitjen, furnizimin dhe sherbimin e garancise per te gjithë  
artikujt e siperpermendur, perfshire dhe linjat complete te  
tyre.

Administrator do te jete Z. Ndriçim Luniku.

Kapitali themeltar 100.000 leke, ortaket, Ndriçim Luniku , 34 % ,  
Dashamir Çadri 33 % , Pirro Kushi 33 % .

**PER KETO ARSYE**

Bazuar ne Ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 Per  
Shoqerite Tregtare Private dhe Nr. 5 te Ligjit date  
10.08.1992 dhe Ligjit Nr. 7667 date 09.01.1993 "Per  
Regjistrimin Tregtar.

## VENDOSA

Regjistrimin si person juridik Shoqerine "NDP" shpk, me ortakeri, Ndriçim Luniku, Dashamir Çadri, Pirro Kushi, me qender ne Tirane Rruga "Mihal Grameno "82/1, Ap. 7, me kohzgjatje 20 vjete , me objekt veprimtarie :

Mirembajtje dhe riparim i pompave te karburantit dhe gazit te lengshem, mirembajtja e linjave elektrike ne stacionet e depot e karburanteve ,mirembajtja dhe riparim i instalimeve dhe programeve kompjuterike,te depozitave te karburanteve dhe te gazit te lengshem.Sherbime te ndryshme qe lidhen me rrjetin kompjuterik ndermjet satcioneve te shitjes se karburanteve e sherbimeve komplekse e depozitave te kaburantit ose te GPL . Mirembajtja dhe sherbimi i aparaturave te ndryshem si elektronike dhe mekanike te cilat perdoren ne stacionet e shitjes e depozitave te karburanteve.Furnizimin me pjeset e kembimit te nevojshme gjate periudhes se garancise per pompat karburantit ,aparatura e sisteme kompjuterike etj, qe i sherbejne qellimit te mesiperme.Shoqeria do te marre gjithashtu koncensione,eskluzivitetedhe perfaqesi per shitjen , furnizimin dhe sherbimin e garanzise per te gjithë artikujt e siper permendur,perfshire dhe linjat complete te tyre.

Administrator i kesaj Shoqerie do te jete Z Ndriçim Luniku .

Kapitali themeltar 100.000( katermiljon )leke, Ndriçim Luniku, 34 %,Dashamir Çadri 33 %,Pirro Kushi 33 %.

Kundr ketij vendimi lejohet ankim ne shkalle te dyte.

## GJYQTARJA


*Manaus.* *Debi*  
*Art. Debi*

## URDHER REGJISTRIMI

I	Nr. regjistrimi	30553
II	A. Emri	N.D.P. Tjpu
	B. Selia	Di. M. Gramo, p82/1 Ap F.
	C. Objekti	Mirëmbajtje dhe riparimi i pajave të karburantit dhe pajave të ngrohjes... shërbime të tjera që lidhen me makinat kompjuterike
	D. Kapitali	100 000 Lekë - Ndësimi kushtesë 34 % - Dëshmorin Cadori 33 % - Tjpu Kurthi 33 %
III	Administratori	Mandësimi kushtesë, Ban. Goleçit banor. Bl. Gjeçan Fllak, Kullë 3. Ap 12/1
IV	Kohezgjatja	5 vjet
	Akt - Themelimi	3 fape.
	Statuti	5 fape + 1 sh
V	Nenshkrimi	
	Statuti	9-11-03      14-11-03
	Akt - Themelimi	

Verifikim për detyrën kapitale  
Nr 8  
në emër H. Gjoçani.

GJYQTARE  
  
 MARIANA DEDI



## AKT THEMELIMI

### PER SHOQERINE "NDP" SHPK

Sot, me daten 31.10.2003

Z. *Ndriçim Luniku*, i biri Galipit, lindur ne Tirane me 24.01.1962, banues ne Blv. "Gj.Fishta", kulla Nr.3, Ap/12/1 (prane Gjykates se Rrethit Tirane)

Z. *Dashamir Çadri*, i biri i Xhevatit, lindur ne Tirane me 07.05.1957, banues ne Rr. "Komuna Parisit" (pallati i ri) Ap/9/e

Z. *Pirro Kushi*, i biri i Vasilit, lindur ne Tirane me 05.12.1949, banues ne Blv. "Zhan D'ark" P.21 Ap.8

mbeshtetur ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" bien dakort te themelojne nje shoqeri tregtare dhe nxjerrin kete Akt Themelimi te shoqerise se re me kushtet si me poshte:

#### Neni 1

Themelohet shoqeria e re me emertimin "NDP" SHPK, me poshte e quajtur thjesht shoqeria, me ortake themelues Z. Ndriçim Luniku, Z. Dashamir Çadri dhe Z. Pirro Kushi

#### Neni 2

Shoqeria eshte person juridik shqiptar. Ajo e ka seline ne Rr."Mihal Grameno" 82/1 Ap.7.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Asamblese, duke respektuar procedurat ligjore ne fuqi.

#### Neni 3

Shoqeria e shtrin veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te çele perfaqesi, dege agjenci apo filiale te saj edhe jashte Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

#### Neni 4

Shoqeria eshte themeluar per te vepruar me afat te caktuar prej 20 vjetesh.

#### Neni 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Mirembajtja dhe riparimi i pompave te karburantit dhe gazit te lengshem, mirembajtja e linjave elektrike ne stacionet e depot e karburanteve, mirembajtja dhe riparimi i instalimeve dhe programeve kmpjuterike per komandimin e stacioneve te shitjes se karburanteve e sherbimeve komplekse, te depozitave te karburanteve dhe te gazit te lengshem. Sherbime te ndryshme qe lidhen me rrjetin kompjuterik ndermjet saticioneve te shitjes se karburanteve e sherbimeve komplekse e depozitave te

karburantit ose te GPL. Mirembajtja dhe sherbimi i aparaturave te ndryshme si elektronike dhe mekanike te cilat perdoren ne stacionet e shitjes e depozitave te karburanteve. Furnizimin me pjeset e kembimit te nevojshme gjate periudhes se garancise per pompa karburanti, aparatura e sisteme kompjuterike etj. qe i sherbejne qellimit te mesiperm. Shoqeria do te marre gjithashtu konçensione, eskuzivitete dhe perfaqesi per shitjen, furnizimin dhe sherbimin e garancise per te gjithë artikujt e siper permendur, perfshire dhe linjat komplete te tyre.

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke. Kapitali themeltar i shoqerise eshte i ndare ne 100 (njeqind) pjese te barabarta.

Neni 7

Kapitali themeltar zoterohet nga ortaket themelues si me poshte

Z. Ndriçim Luniku	34%	ose 34 pjese te barabarta
Z. Dashamir Çadri	33%	ose 33 pjese te barabarta
Z. Pirro Kushi	33%	ose 33 pjese te barabarta

Neni 8

Kapitali themeltar eshte i shprehur teresisht ne para dhe plotesisht i likujduar para noterit.

Neni 10

Organet drejtuese te shoqerise jane:

Asambleja e ortakeve

Administratori

Neni 11

Veprimtaria e shoqerise pasqyrohet ne bilancet financiare qe hartohen ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Fitimi i rezultuar nga veprimtaria vjetore, mbas zbritjes se rezervave ligjore dhe atyre te percaktara nga Asambleja, ndahet ne forme dividenti, per ortaket e shoqerise, sipas % qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar.

Neni 12

Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise deri ne kufirin e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.



Neni 13

Shoqeria mund te mbylle veprimtarine e saj me vendim te Asamblese dhe ne baze te ligjit.

Mbyllja e veprimtarise se shoqerise behet ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 14

Dispozita te hollesishme per veprimtarine e shoqerise dhe te organeve drejtuese te saj percaktohen ne Statut.

ORTAKET THEMELUES


Ndriçim Luniku



Dashamir Çadri



Pirro Kushi



# STATUTI

## I SHOQERISE "NDP" SHPK

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te Aktit te Themelimit te shoqerise "NDP" Sh.p.k., ortaket themelues miratojne kete Statut per veprimtarine e shoqerise

### Neni 1

Ortaket themelues, *Z. Ndrichim Luniku*, i biri Galipit, lindur ne Tirane me 24.01.1962, banues ne Blv. "Gj.Fishta", kulla Nr.3, Ap/12/1 (prane Gjykates se Rrethit Tirane), *Z. Dashamir Cadri*, i biri i Xhevatit, lindur ne Tirane me 07.05.1957, banues ne Rr. "Komuna Parisit" (pallati i ri) Ap/9/e dhe *Z. Pirro Kushi*, i biri i Vasilit, lindur ne Tirane me 05.12.1949, banues ne Blv. "Zhan D'ark" P.21 Ap.8 kane krijuar shoqerine tregtare "NDP" Sh.p.k., me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

### Neni 2

Shoqeria eshte person juridik shqiptar. Veprimtaria e saj bazohet ne legjislacionin ne fuqi, ne normat e percaktuara ne kete Statut dhe ne Vendimet e Asamblese se ortakeve.

### Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne Rr."Mihal Grameno" 82/1 Ap.7. Selia e shoqerise mund te ndryshohet me vendim te Asamblese duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi.

### Neni 4

Shoqeria e shtrin veprimtarine e saj ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise. Ajo mund te çele zyra perfaqesimi, agjensi, dege e filiale te saj edhe ne vende te tjera, duke respektuar legjislacionin e vendit perkates.

### Neni 5

Shoqeria eshte krijuar per te vepruar per nje afat prej 20 vjetesh.

### Neni 6

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:

Mirembajtja dhe riparimi i pompave te karburantit dhe gazit te lengshem, mirembajtja e linjave elektrike ne stacionet e depot e karburanteve, mirembajtja dhe riparimi i instalimeve dhe programeve kompjuterike per komandimin e stacioneve te shitjes se karburanteve e sherbimeve komplekse, te depozitave te karburanteve dhe te gazit te lengshem. Sherbime te ndryshme qe lidhen me rrjetin kompjuterik ndermjet stacioneve te shitjes se karburanteve e sherbimeve komplekse e depozitave te

karburantit ose te GPL. Mirembajtja dhe sherbimi i aparaturave te ndryshme si elektronike dhe mekanike te cilat perdoren ne stacionet e shitjes e depozitave te karburanteve. Furnizimin me pjeset e kembimit te nevojshme gjate periudhes se garancise per pompa karburanti, aparatura e sisteme kompjuterike etj. qe i sherbejne qellimit te mesiperm. Shoqeria do te marre gjithashtu konçensione, eskluзивitete dhe perfaqesi per shitjen, furnizimin dhe sherbimin e garancise per te gjithë artikujt e siper permendur, perfshire dhe linjat complete te tyre.

Neni 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke. Kapitali themeltar eshte i shprehur teresisht ne para dhe i likujduar teresisht para noterit.

Neni 8

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 (njqind) pjese te barabarta, secila me vlere nominale prej 1 000 ( njemije ) leke.

Neni 9

Kapitali themeltar zoterohet nga ortaket themelues si me poshte

Z. Ndrichim Luniku	34%	ose 34 pjese te barabarta
Z. Dashamir Çadri	33%	ose 33 pjese te barabarta
Z. Pirro Kushi	33%	ose 33 pjese te barabarta

Neni 10

Kapitali themeltar mund te ndryshoje, te rritet apo zvogelohet duke respektuar dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 11

Pjeset e barabarta te kapitalit themeltar nuk mund te jene te tregtueshme lirisht. Ortaket kane te drejten paresore ne blerjen e pjeseve te barabarta, kur çdo njeri prej ortakeve deshiron t'i shese ato.

Ne çdo rast shitje te pjeseve te barabarta te kapitalit themeltar te shoqerise, ortaket e tjere gezojne te drejten e parablerjes ne perputhje me % qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar ne momentin e shitjes.

Neni 12

Per rastet e trashegimise zbatohen dispozitat ligjore ne fuqi. Ne keto raste do te perfshihen dhe ndryshimet qe pesojne personat juridike qe jane ortake te shoqerise.





Neni 13

Organet drejtuese te shoqerise jane:  
Asambleja e ortakeve,  
Administratori.

Neni 14

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte drejtues i shoqerise. Ajo perbehet nga teresia e ortakeve qe zoterojne pjese te barabarta ne kapitalin themeltar te shoqerise. Aktualisht Asamblea perbehet nga ortaket:

Neni 15

Asambleja e ortakeve eshte e Zakonshme dhe e Jashtezakonshme.  
Asambleja e Jashtezakonshme vendos per ndryshimin e kapitalit, per çdo ndryshim ne Aktin e Themelimit dhe ne kete Statut si dhe per çdo gje qe ne baze te ligjit eshte ne kompetence te saj.  
Asambleja e Zakonshme vendos per gjithë çështjet e tjera te shoqerise.

Neni 16

Te drejten e thirjes se mbledhjes se Asamblese e ka çdo ortak qe zoteron jo me pak se 5% te pjeseve te barabarta te kapitalit themeltar, administratoret si dhe personat e percaktuar ne baze te ligjit apo me vendim te Gjykates.

Neni 17

Asambleja thirret ne mbledhje jo me pak se 1 here ne vit. Mbledhja e Asamblese behet zakonisht prane selise se shoqerise. Ajo mund te behet edhe ne çdo vend tjeter, me kusht qe vendi te jete percaktuar saktesisht ne njoftimin per mbledhje

Neni 18

Njoftimi per mbledhjen e Asamblese duhet t'u dorezohet ortakeve jo me vone se 15 dite perpara mbledhjes se Asamblese. Kur ortaku eshte person juridik dorzimi i njoftimit per mbledhjen e Asamblese por dhe i çdo komunikimi tjeter do te behet ne seline e shoqerise ose ne adresen e percaktuar me shkrim nga vete ortaku. Kur ortaku eshte person fizik dorzimi i njoftimit per mbledhjen e Asamblese behet ne adresen e percaktuar nga vete personi. Shenimi i postes per shkak se ne adresat e percaktuara si me sipër nuk ka njeri eshte i vlefshem per ta konsideruar te realizuar komunikimin.

Neni 19

Lajmerimi per mbledhjen e Asamblese duhet te permbaje rendin e dites, daten dhe oren e mbledhjes, vendin e mbledhjes. Ne rastet e Asamblese se Jashtezakonshme kjo duhet te shprehet saktesisht.



- 4 -

**Neni 20**

Pergatitja per mbledhjen e Asamblese eshte ne ngarkim te atyre qe kerkojne thirrjen e saj. Ne te gjitha rastet administartori eshte i detyruar te marri masat per realizimin e mbledhjes se Asamblese.

**Neni 21**

Dokumentat qe do te shqyrtoje Asambleja vihen ne dispozicion te ortakeve, ne seline e shoqerise jo me vone se 5 dite para mbledhjes se Asamblese.

**Neni 22**

Ne mbledhje te Asamblese mbahet procesverbali, i cili nenshkruset nga ortaket pjesmarres dhe sekretari.

**Neni 23**

Asambleja eshte e vlefshme ne rast se permbushen kushtet e kerkuara nga ligji nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare". Vendimet e Asamblese merren me shumicen e votave sipas percaktimeve ne dispozitat ligjore per shoqerite tregtare.

**Neni 24**

Veprimtaria e zakonshme e shoqerise drejtohet nga administratori.

**Neni 25**

Administrator i shoqerise, emerohet Z Ndriçim Luniku.

**Neni 26**

Administratori eshte perfaqesues ligjor i shoqerise dhe ka ne kompetence te gjitha ceshtjet qe lidhen me administrimin e shoqerise, me perjashtim te atyre qe ligji i percakton si kompetence te Asamblese.

**Neni 27**

Marredheniet e punes me shoqerine jane ne kompetence te administratorit dhe rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

**Neni 28**

Administratori i shoqerise eshte perfaqesues ligjor i shoqerise ne marredheneiet e saj me gjithe personat e trete dhe me organet shteterore e gjyqesore.

Neni 29

Veprimtaria financiare e shoqerise pasqyrohet ne bilancet financiare. Ushtrimi financiar fillon me daten 01 Janar dhe mbaron me daten 31 Dhjetor te çdo viti kalendarik. Ben perjashtim viti i fillimit te veprimtarise, ne te cilin si date fillimi do te merret ajo e regjistrimit ne organet kompetente.

Neni 30

Ortaket jane pergjegjes per humbjet qe rezultojne nga veprimtaria e shoqerise deri ne kufirin e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar.

Neni 31

Administratori eshte pergjegjes per hartimin e bilancit e te llogarive vjetore te shoqerise. Kur eshte rasti Asambleja emerone dhe ekspertin kontabel te autorizuar.

Neni 32

Fitimet qe rezultojne nga veprimtaria e shoqerise , mbas zbritjes se rezervave ligjore, ndahen sipas vendimit perkates te Asamblese.

Neni 33

Shoqeria mund ta mbylle veprimtarine e saj kur jane rastet e parashikuara ne ligj apo me vendim te Asamblese se oratkeve.

Neni 34

Ne çdo rast te mbylljes se veprimtarise se shoqerise zbatohen dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 35

Ne rastin e mbylljes se veprimtarise se shoqerise, vlera e pasurise qe mbetet, pas likuidimit te gjithë detyrimeve, ndahet ndermjet ortakeve, ne perputhje me perqindjen e pjeseve te barabarta te kapitalit htemeltar qe ata zoterojne ne momentin e marrjes se vendimit per mbyllje.

Neni 36

Per çdo gje qe nuk eshte shprehur posaçerisht ne kete Statut i referohet dispozitave ligjore per shoqerite tregtare, pjesa per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar.

ORTAKET THEMELUES

Ndriçim Luniku

Dashamir Cadri

Pirro Klushi

REPUBLICA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERIT TIRANE  
Notere Hatixhe Gojani  
Nr. 3351 rep.


VERTETIM – NENSHKRIMI


Ne Tirane , sot me date 07.11. 2003 , para meje noteres Hatixhe Gojani , me seli prane Gjykates se Rrethit Tirane, u paraqite personalisht ortaket e shoqerise “NDP”shpk, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , te identifikuar dhe njohur prej meje personalisht me pasaporte, te cilet ne baze te vullnetit te lire dhe te plote , nenshkruan Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise “NDP “shpk, e redaktuar jashte kesaj zyre , pasi u gjend ne pajtim te plote te vullnetit e tyre , nenshkruhet pa vrejte dhe une si notere , vertetoj nenshkrimin e tyre konform ligjit .

NOTERE

Hatixhe Gojani

*Takra pulles u paguor  
kopje aktiniet*





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERIT TIRANE

Nr. 8 Rep.

VERTETIM

Prane kesaj zyre eshte derdhur kapitali themeltar i Shoqerise "NDP" shpk, me  
adminstrator Ndrçim Luniku, ne vleren 100.000 leke ( njeqinde mije ) leke.

NOTERE  
Hatixhe Gojani

30553

3 M Ded  
11 11 2003  
11 NENTOR 2003

KERKESE

Kerkues : Shoqeria "NDP" SHPK Tirane me seli ne ne Rr."Mihal Grameno" 82/1 Ap.7, perfaqesuar nga administratori Z Ndrichim Luniku, i biri i Galipit dhe i Aferdites banues ne Tirane, Blv. "Gjergj Fishta", kulla Nr.3 Ap.12/1 (prane Gjykates Rrethit Tirane).

Objekti Depozitimi i Aktit te Themelimit dhe Statutit te shoqerise "NDP" SHPK

Baza ligjore: Ligji nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

GJYKATES SHKALLES PARE

TIRANE

*Pa regjistruar  
statutit  
14-11-03*

Ortaket themelues, mbeshtetur ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" kane vendosur krijimin e nje shoqerie me emertimin "NDP" SHPK, me statusin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, me seli Rr. "Mihal Grameno" P.82/1 Ap.7.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte:


Mirembajtja dhe riparimi i pompave te karburantit dhe gazit te lengshem, mirembajtja e linjave elektrike ne stacionet e depot e karburanteve, mirembajtja dhe riparimi i instalimeve dhe programeve kmpjuterike per komandimin e stacioneve te shitjes se karburanteve e sherbimeve komplekse, te depozitave te karburanteve dhe te gazit te lengshem. Sherbime te ndryshme qe lidhen me rrjetin kompjuterik ndermjet stacioneve te shitjes se karburanteve e sherbimeve komplekse e depozitave te karburantit ose te GPL. Mirembajtja dhe sherbimi i aparaturave te ndryshme si elektronike dhe mekanike te cilat perdoren ne stacionet e shitjes e depozitave te karburanteve. Furnizimin me pjeset e kembimit te nevojshme gjate periudhes se garancise per pompa karburanti, aparatura e sisteme kompjuterike etj. qe i sherbejne qellimit te mesiperem. Shoqeria do te marre gjithashtu konçensione, eskuzivitete dhe perfaqesi per shitjen, furnizimin dhe sherbimin e garancise per te gjithë artikujt e siper permendur, perfshire dhe linjat komplete te tyre.



Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njqindmije ) leke dhe i ndare ne 100 pjese te barabarta, me vlere nominale secila prej 1000 leke.

Kapitali themeltar zoterohet nga ortakët themelues si me poshte:

- Z. Ndrichim Luniku 34% ose 34 pjese te barabarta
- Z. Dashamir Çadri 33% ose 33 pjese te barabarta
- Z. Pirro Kushi 33% ose 33 pjese te barabarta



Shoqeria thmelohe per te vepruar ne nje afat kohor prej 20 vjetesh.

Administrator i shoqerise per nje periudhe 3 vjeçare eshte emeruar Z Ndriçim Luniku, i biri i Galipit dhe i Aferdites banues ne Tirane, Blv. "Gjergj Fishta", kulla Nr.3 Ap.12/1 (prane Gjykates Rrethit Tirane).

Mbeshtetur ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" kerkojme nga ana juaj shqyrtimin e dokumentave te themelimit dhe depozitimin e Aktit te Themelimit dhe Statutit te shoqerise "**NDP**" SHPK ne Regjistrin Tregtar.

Tirane me 04.11.2003

ADMINISTRATORI  
Ndriçim Luniku

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERIT TIRANE  
Notere Hatixhe Gojani  
Nr. 3350 rep.

VERTETIM – NENSHKRIMI

Ne Tirane , sot me date 07.11. 2003 , para meje noteres Hatixhe Gojani , me seli prane Gjykates se Rrethit Tirane, u paraqite personalisht deklaruesi:

Ndriçim Luniku i biri i Galipit dhe i Aferdites ,lindur me 24.01.1962, banues ne Tirane Rruga “Gjergj Fishta “ , madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar , i njohur prej meje si notere ,i cili ne baze te vullnetit te lire dhe te plote, nenshkroje kerkesen e redaktuar jashte kesaj zyre , dhe pasi u gjend ne pajtim te plote , edhe une si notere e vertetoje konforme ligjit nenshkrimin e tij .



NOTERE  
  
Hatixhe Gojani

